



NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE
PUBLIC HOUSING ENTERPRISE

Adr: Rr. "Xhevdet Doda" nr. 32 - Prishtinë-Kosovë
Tel: +381(0)38 553 311/523 001; Fax: +381 (0)38 522 446
e-mail: npb@npbanesore.com web: www.npbanesore.com

Nr. i Protokollit: _____

Data: _____

Ndërmarrja Publike Banesore shpall këtë:

K O N K U R S
KONTRATË PËR KONSULENCË LIGJORE DHE
PËRFAQËSIM GJYQËSOR

Titulli: (1) Avokat për konsulencë ligjore dhe përfaqësim gjyqësor

Periudha: 12 muaj;

Kompensimi: 500 EUR (pesë qind euro) në muaj

Raporton: Menaxherit të Departamentit për Mbështetje të Brendshme

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- a) Përfaqësimi dhe mbrojtja e institucionit para të gjitha organeve shtetërore në Kosovë si organet publike, policia, prokuroria, gjykatat civile, administrative dhe penale;
- b) Dhënia e këshillave juridike lidhur me kornizën ligjore të Kosovës, sipas nevojës, duke përfshirë, ndër të tjera, çështjet juridike lidhur me kornizën ligjore të Republikës së Kosovës;
- c) Përgatitja dhe dorëzimi i parashtrësave të nevojshme, ndër të tjera, padi, përgjigje në padi, ankesa, kërkesa dhe kundërshtime;
- d) Marrja e të gjitha veprimeve të nevojshme civile dhe penale për kompensimin e dëmit eventual;
- e) Negocimi dhe përpilimi i kontratave në emër të Ndërmarrjes;
- f) Si dhe çështje të natyrës së njejtë sipas kërkesës së Ndërmarrjes;

Kushtet themelore të nevojshme për angazhimin në punë dhe detyra specifike:

- Të jetë i/e licencuar si Avokat/e nga oda Avokatëve të Kosovës;
- Së paku 1 vit përvojë profesionale si avokat;
- Të ketë përvojë të përfaqësimit pranë të gjitha instancave gjyqësore në Republikën e Kosovës.
- Shkathësi të shkëlqyeshme ndërpersonale dhe të komunikimit, si dhe aftësi në zgjidhjen e konfliktit;
- Saktësi, vëmendje në detaje dhe ndjeshmëri ndaj prioriteteve;
- Të ketë aftësi për të punuar në mënyrë efektive nën presion të kohës;
- Të ketë aftësi në hartim të Rregulloreve apo akteve të brendshme që ndërlidhen me fushëveprimtarinë e Ndërmarrjes.

Mënyra e konkurimit:

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në zyrat e Burimeve Njerëzore të Ndërmarrjes Publike Banesore apo ta shkarkojnë nga web faqja e internetit në adresën: www.npbanesore.com/shpalljet/mundesi-punesimi/ .

Dokumentacionin mund ta paraqesin në kopje fizike në Divizionin e Burimeve Njerëzore në adresën: rr. Xhevdet Doda, nr. 32, Prishtinë, të aplikojnë përmes emailit zyrtar: burimet.njerezore@npbanesore.com apo përmes postës. Kandidatët të cilët konkurojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe email adresën. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- CV/Resume;
- Formulari i Aplikimit
- Dëshmi mbi përgatitjen profesionale;
- Dëshmitë për përvojën e punës;
- Licencën nga Oda Avokatëve;
- Kopje e dokumentit identifikues (leternjoftim, pasaporte, etj)
- Letrën përcjellëse/ motivuese;

Kriteret e përzgjedhje:

- Përparsi kanë avokatët të cilët trajtojnë çështje nga e drejta komerciale, pronësore-juridiko-civile.

Mënyra e përzgjedhjes:

- Përzgjedheja e avokatit do të bëhet në bazë të dokumentacionit të ofruar nga kandidatët që përputhet me kërkesat e konkursit.

***Shënim:** Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda tri (2) ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohen.*

APLIKACIONET DHE DOKUMENTACIONI I PAKOMPLETUAR SIPAS KËRKESAVE TË PËRCAKTUARA NË KËTË SHPALLJE SI DHE ATO QË ARRIJNË PAS SKADIMIT TË AFATIT TË KONKURSIT, NUK DO TË SHQYRTOHEN.

Shpallja është e hapur që nga data 13.02.2021-16.02.2021

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në Divizionin e Burimeve Njerëzore të Ndërmarrjes Publike Banesore në nr. tel. : 038 606 672.